



(II)

# UDHA E KRYQIT

NË GJURMËT E TË LUMTURVE

MARTIRË TË KOMUNIZMIT (1947-1948)

NË ISH- BURGUN E SIGURIMIT TË SHKODËR -  
SHKODËR



Tekstet e Udhës së Kryqit janë nxjerrë nga vëllimet e Atë Leonardo Di Pinto-s O.F.M.: *“Imzot Vinçenc Prennushi me Shokë Martirë”*, profil historik hagjiografik, enti botues Arqipeshkvia Shkodër-Pult, Shtator 2016.

Nën kujdesin e Motrave Klarise

Manastiri “Sh. Kjara”- Shkodër-

# UDHA E KRYQIT

**M.** Në emër të Atit e të Birit e të Shpirtit Shenjt.

**P.** **Amen.**

**M.** Hiri i Zotit tonë Jezu Krishtit, dashuria e Hyjit Atë dhe ndikimi i Shpirtit Shenjt qoftë me ju të gjithë.

**P.** **Dhe me shpirtin tënd.**

**M.** Në fillim të udhëtimit të kryqit kërkojmë mëshirën e Zotit:

O Zot, ki mëshirë.

**P.** **O Zot, ki mëshirë.**

**M.** O Krisht, ki mëshirë.

**P.** **O Krisht, ki mëshirë.**

**M.** O Zot, ki mëshirë.

**P.** **O Zot, ki mëshirë.**

**M.** Të adhurojmë o Krisht, e të bekojmë.

**P.** **Pse me kryqin tënd të shenjtë e shpërbleve botën mbarë.**

**M.** **Të lutemi.**

O Zot Jezu Krisht, të ndjekim me fe e me dashuri në rrugën tënde të kryqit. Dhimbja jote qoftë dhimbja jonë. Kryqi yt qoftë kryqi ynë. Vdekja jote qoftë vdekja jonë. Kështu do të jemi me ty në lavdinë e ringjalljes për të gjithë shekuj të shekujve.

**P. Amen.**

*Rrite Zoja tuj lotue,  
afër kryqit tuj shikue,  
Krishtin pezull kryqëzue.*

*Nanë e dashtun, t'lus pa pra,  
varrët e t'birin tand pa da,  
Gjurma n'zemër me m'i ba.*

## TË NDALURIT E PARË

### JEZU KRISHTIN E DËNOJNË ME VDEKJE

**M. T'adhurojmë, o Krisht, e të bekojmë.**

**P. Pse me kryqin tënd të shenjtë e shpërbleve botën mbarë.**

*Prej librit të Isaisë Profet (Is 42,1)*

“Ja, Shërbëtori im që unë e përkrah, i zgjedhuri im, në të cilin kënaqet shpirti im. Mbi të e kam ndikuar shpirtin tim; ai do t'ua japë të drejtën popujve”.

*Nga hagiografia e Imzot Vinçenc Prennushit, O.F.M., Arqipeshkëv*

Në burg, ndër të tjera, për ta poshtëruar, e detyruan të mbante “karrocën” e plehrave. E lidhnin duarsh e këmbësh dhe e varnin me një litar në një banjë të burgut derisa e binte të fikët...e pastaj përsëri e njëjta torturë. E nuk mjafton kjo. Atë Zef Oroshi thotë: “Imzot Vinçenc Prennushi, Arqipeshkëv i Durrësit, i njohur për shenjtërinë e tij të jetës dhe për vlerën e tij si shkrimtar, sidomos i argumenteve fetare, përveç mundimeve të tjera të panjohura për ne, u torturua prej seksionit të Sigurimit në këtë mënyrë. Pasi e zhveshën, e mbyllën në një kafaz prej hekuri të përgatitur pikërisht për tortura me gozhda me majë përbrenda: aty e rrotulluan gati çdo ditë, për javë të tëra. Më së fundi vdiq”. “Forca e tij e frymëzuar prej fesë, krenaria e tij në tortura, jeta e tij si Bari, e jetuar denjësisht, edhe sot në orët më të vështira, ndriçojnë figurën e tij prej françeskani”. Në lidhje me këtë, Karlo Grashi ka shtuar: “Siç më tha drejtori i atëhershëm i burgut, Imer Haçkovja, Imzot Prennushi u soll me dinjitet duke mos folur shumë; ishte i qeshur, i kthjellët, i respektueshëm dhe paqësor me të gjithë”.

*Nga Letra enciklike e Atit të Shenjtë Françesku “Vëllezër të gjithë”*

Duhet të pranojmë se në jetën tonë gjykimi i rreptë që kam në zemrën time kundër vëllait apo motrës sime, ajo plagë e pamjekuar, ajo e keqe e pafalur, ai inat i fshehtë që do të më bëjë vetëm keq, është një copë lufte që mbart përbrenda, është një vatër zjarri në zemër, që duhet shuar, me qëllim që të mos ndizet zjarr.

**M. Të lutemi:**

O Jezu Krisht, i përvuajtë dhe zemërbutë, i dënuar me pa të drejtë për mëkatet tona. Na shiko me mirësi të gjithë ne, që shpesh jemi të verbër dhe të pandjeshëm, që gjykojmë dhe dënojmë vëllezërit dhe motrat tona. Na e jep neve dhe atyre faljen Tënde! Ti që jeton e mbretëron në shekuj të shekujve.

**Mëshirë për ne, o Zot!**

*Heshta zemrën prej trishtimit,  
prej ezgjetit, prej idhnimit,  
Zojës përshkue ia kishte shqimit.*

*Nanë e dashtun, t'lus pa pra,  
varrët e t'birin tand pa da,  
Gjurma n'zemër me m'i ba.*

## TË NDALURIT E DYTË

### JEZU KRISHTI ËSHTË NGARKUAR ME KRYQ

**M. T'adhurojmë, o Krisht, e të bekojmë.**

**P. Pse me kryqin tënd të shenjtë e shpërbleve botën mbarë.**

*Prej librit të Isaisë Profet (Is 50,6)*

“Shpinën ua solla atyre që më rrahnin, mollëzat e mia atyre që ma shkulnin mjekrrën: fytyrën time nuk e largova nga të sharat e pështymat”.

*Nga hagiografia e Atë Serafin Kodës, O.F.M.*

Me bindje Gjon Pashku nga Lezha ka thënë për të: “Për të nuk mund të thuash asgjë të keqe”. Ishte shume i zellshëm dhe i palodhur në kryerjen e misionit të tij si meshtar dhe famullitar. Veçanerisht ishte i devotshëm pas Zojës dhe Shën Antonit, devocion që pa u lodhur ua ushqente edhe besimtarëve të vet, duke këshilluar lutjen e Ruzaren në familje. E vërteta ishte se Atë Serafini, duke qenë shumë i angazhuar në veprimtarinë e tij si famullitar, populli i qëndronte shumë afër dhe e ndiqte dhe kjo për regjimin përbënte një krim, pra një rast i mirë për ta arrestuar. “Kaluan dy muaj dhe Atë Serafinin e sollën në spital për vdekje nga torturat dhe mundimet që kishte hequr ai në burg”. Dikush ka thënë se ndërsa nga burgu e transferonin të sfilitur në spital, duke parë jashtë kishës statore e Zojës, ka thënë: “O Zojë, shpejto e më jep ngushëllimin tënd!”. 54 vjeç, i mbuluar me plagë dhe djegie, mëngjesin e datës 11 maj 1947 u shua atje, në kuvendin-famulli të tij, ku, pa asnjë ankesë, në vuajtjen më të tmerrshme dhe në braktisjen më të plotë, kishte ushtruar detyrën e fundit, sigurisht më të lavdishmen, të mbarështimit të tij meshtarak në cilësinë e famullitarit. Pashko Gjoni ka thënë: “Atë Serafini ka vdekur për fenë dhe nëse ka dhënë jetën për Krishtin, me siguri është shenjt”, dhe përsëri “jeta e tij prirej drejt vdekjes ashtu siç krejtësisht i kushtuar Krishti dhe Kishës”.

*Nga Letra enciklike e Atit të Shenjtë Françesku “Vëllezër të gjithë”*

Të kujdesesh për brishtësinë do të thotë forcë dhe butësi, do të thotë luftë dhe frytshmëri në mes të një modeli funksionalist dhe privatist që të çon në mënyrë të pashmangshme në “kulturën e hedhjes”. Do të thotë të marrësh përgjegjësinë për të tashmen në situatën e saj më mënjanuese dhe shqetësuese dhe të jesh në gjendje ta veshësh atë me dinjitet.

**M. Të lutemi:**

O Jezus, Zoti ynë, që mbart kryqin në shpatullat e Tua të pafajshme, shikoj të gjithë njerëzit që e shpërfillin dhimbjen dhe lodhjen e të ngjashmëve të tyre. Bëj që të gjithë ne të mund të luftojmë dhe të përpiqemi për lirin e njeriut. Ti që jeton e mbretëron në shekuj të shekujve.

**Mëshirë për ne, o Zot!**

*Oh sa n'vaj e sa n'ankim,  
ke n'atë çast pa pasë një g'zim,  
Nana Krishtit veç bekim.*

*Nanë e dashtun ...*

## TË NDALURIT E TRETË

### JEZU KRISHTI BIE TË PARËN HERË NËN KRYQ

**M. T'adhurojmë, o Krisht, e të bekojmë.**

**P. Pse me kryqin tënd të shenjtë e shpërbleve botën mbarë.**

*Prej librit të Isaisë Profet (Is 53,3)*

‘Ishte i përbuzur më i sprasmi ndër njerëz, njeri dhimbjesh, i regjur me vuajtje, si ai, para të cilit mbulohet fytyra, i përbuzur, këndeja as s’e çmonin për gjësend!’

*Nga hagiografia e Vëlla Gjon Pantalisë, S.I.*

Gjathë muajve të parë të përndjekjes Fratel Gjoni ka ndhimuar me të gjitha mjetet e mundshme meshtarët e arrestuar, pa e ditur se një ditë edhe ai do të kishte të njëjtin fund. Sigurimi e kishte vënë në shënjestër klerin, pra edhe Fratel Pantalija duhej të arrestohej. Prej tij shpresonin të dinin ndonjë gjë në lidhje me bashkësinë e jezuitëve, meqenëse ai ishte ekonom. Arrestimi i tij nuk ndodhi për ndonjë veprim të bërë kundër Shtetit, por vetëm sepse ishte Jezuit.

Zef Kaçi ka thënë: “E torturuan shumë. Sigurimi i ndante torturat sipas rëndësisë dhe konsideratës që gëzonte personi. Sa më shumë që një person ishte aktiv dhe i dashur në popull, aq më shumë silleshin me të në mënyrë barbare. Por gjatë të gjitha këtyre torturave, vetëm me hirin e Hyjit, arriti të sillej heroikisht”.

Vdiq pa gjyq, pa vendim, pa mbrojtje, pa shpjegime dhe pa dënim. Martirizimi i Fratel Gjoni duhet të vendoset në klimën e përgjithshme të urrejtjes dhe fanatizmit fetar të kohës.

*Nga Letra enciklike e Atit të Shenjtë Françesku “Vëllezër të gjithë”*

Si kalimtar i rastit në historinë e samaritanit të mirë, duhet vetëm dëshira falas, e pastër dhe e thjeshtë për të qenë popull, për të qenë të qëndrueshëm dhe të palodhshëm në angazhimin për të përfshirë, për të integruar dhe për të ngritur atë që është rrëzuar.

**M. Të lutemi:**

O Zot Jezus, të lutemi për të gjithë ne mëkatarët. Na shiko të gjithë me mirësi dhe na shëro nga sëmundjet tona shpirtërore me dashurinë Tënde të mëshirshme. Ti që jeton e mbretëron në shekuj të shekujve.

**Mëshirë për ne, o Zot!**

*Kjante dneste e dhimshmja nanë,  
mundue Krishtin për gjithë anë,  
Pa muj kush një ndihmë m'ia dhanë.*

*Nanë e dashtun ...*

## TË NDALURIT E KATËRT

### JEZU KRISHTI HAS NË NËNËN E VET

**M. T'adhurojmë, o Krisht, e të bekojmë.**

**P. Pse me kryqin tënd të shenjtë e shpërbleve botën mbarë.**

*Prej librit të Isaisë Profet (Is 49,1)*

“Më dëgjoni, o ishuj, vështroni me kujdes, popuj të largët: Zoti më thirri prej prehrit të nënës, prej barkut të nënës sime iu kujtua emri im.”

*Nga hagiografia e Dom Anton Muzajt*

Në atë Gjetseman të dhimbshëm, në atë ferr torturash mizore, të cilat “ia dhuronin” në mënyrë të pamëshirshme, pavarësisht se ishte i ri dhe i pafajshëm, si edhe i sëmurë nga tuberkolozi, sjellja dinjitoze dhe e përvuajtur e Dom Anton Muzajt, qe shembull edhe për të burgosurit. Ndërsa e çonin nga qelia për ta marrë në pyetje dhe anasjellas ishte në gjendje të mjerueshme. Nuk arrinte as të ecte, ndoshta sepse i kishin dëmtuar gjymtyrët e poshtme dhe prandaj e zvarrisnin për krahësh, ndërsa kryet i varej i gjakosur. Madje për pak kohë e mbajtën të mbyllul në një banjë dhe aty papushim thoshte me zë të lartë: “Në emër të Atit, të Birit e të Shpirtit Shenjt”. Dhe “Rroftë Krishti Mbret!”. Vdiq në pranverën e vitit 1948, ishte 27 vjeç. Nuk mund të përfytyrohet vuajtja që përjetuan prindërit dhe familjarët e tij kur morën vesh lajmin e fundit të tij tragjik.

*Nga Letra enciklike e Atit të Shenjtë Françesku “Vëllezër të gjithë”*

Kjo ecje vëllazërie ka edhe një Nënë, me emrin Mari. Ajo e ka marrë në këmbët e Kryqit këtë amësi universale dhe vëmendja e saj është drejtuar jo vetëm ndaj Jezusit, por edhe ndaj “tepricës së pasardhësve të saj”. Me fuqinë e të Ngjallurit, dëshiron të lindë një botë të re, ku të gjithë jemi vëllezër, ku ka një vend për çdo të skartuar nga shoqëritë tona, ku shkëlqejnë drejtësia dhe paqja.

**M. Të lutemi:**

Bëj, o Zot Jezus, nëpërmjet lutjeve të Nënës Tënde të Shenjtë, që ta imitojmë forcën e saj gjatë rrugës së Kalvarit. Ti që jeton e mbretëron në shekuj të shekujve.

**Mëshirë për ne, o Zot!**

*Tuj kqyrë nanën e Tenzot,  
afër Krishtit me varrë plot,  
S'asht njeri që s' derdh lot.*

*Nanë e dashtun ...*

## TË NDALURIT E PESTË

### JEZU KRISHTI NDIHMUAR PREJ CIRENEUT

**M. T'adhurojmë, o Krisht, e të bekojmë.**

**P. Pse me kryqin tënd të shenjtë e shpërbleve botën mbarë.**

*Prej librit të Isaisë Profet (Is 42,6)*

“Unë, Zoti, të thirra në drejtësi e për dore të kam marrë; të kam trajtuar e caktuar besëlidhje të popullit edhe dritë për të gjithë popujt: që t’ua hapësh sytë të verbërve”.

*Nga hagiografia e Atë Bernardin Palajt, O.F.M.*

Regjimi, pasi u vendos dhe mori në dorë pushtetin, fillimisht nisi të luftonte “paragjykimin fetar”. Pastaj, me fuqi me anë të ligjeve të frymëzuara nga ky parim, synohej t’i hiqej besimit çdo mundësi për të ekzistuar. Kjo gjë ndodhi më 6 shkurt 1967, kur diktatori e shpalli Shqipërinë Shtetin e parë ateist në botë. Si rrjedhojë, personaliteti i spikatur i të ndriturit Atë Palajt, i cili mbahej nën vëzhgim prej kohësh, nuk mun t’i ikte sundimitarit të ri. Kaluan rrëth dy vjet e Regjimi e akuzoi se ishte “agjent dhe bashkëpunëtor i të huajve”. Tom Leci, shok burgu dhe i mbijetuar, kujton: “Në kopshtin e kuvendit të Sh.Françeskut të Gjuhadorit në Shkodër kishte disa pemë dhe shumë herë, pasi na rrihnin për vdekje, na lidhnin te ato. Si të ishte sot, shoh Atë Bernardin Palajn të lidhur e të varur para meje. E kishin rrahur aq shumë sa kishte humbur ndjenjat dhe varej pa jetë...”.

*Nga Letra enciklike e Atit të Shenjtë Françesku “Vëllezër të gjithë”*

Nga thellësia e çdo zemre, dashuria krijon lidhje dhe zgjeron ekzistencën kur e nxjerr personin nga vetja e tij drejt tjetrit. Jemi krijuar për dashurinë dhe në secilin prej nesh ka “një lloj ligji ‘ekstaze’: të dalësh prej vetes për të gjetur tek të tjerët një shtim të vetes”. Prandaj “në çdo rast, njeriu gjithashtu duhet të vendosë që të dalë menjëherë jashtë vetvetes”.

**M. Të lutemi:**

O Zot Jezus, na mëso të gëzojmë për të mirën e të tjerëve. Digje me dashurinë Tënde zilinë që gërryen zemrën tonë. Ti që jeton e mbretëron në shekuj të shekujve.

**Mëshirë për ne, o Zot!**

*Kush sheh zojën n'atë ezgjet,*

*gati dekun për djalë t'vet,*

*Pa dnesue, jo, nuk jet.*

*Nanë e dashtun ...*

## TË NDALURIT E GJASHTË

### VERONIKA IA FSHIN FYTYRËN JEZU KRISHTIT

**M. T'adhurojmë, o Krisht, e të bekojmë.**

**P. Pse me kryqin tënd të shenjtë e shpërbleve botën mbarë.**

*Prej librit të Isaisë Profet (Is 52,14)*

“Sikurse shumë vetë që mbetën shtang kur e panë, kaq e shëmtuar ishte pamja e tij, fytyra e tij s’ishte më si e njeriut, aq sa pamja e tij s’ishte më si e bijve të Adamit, po ashtu mbi Të do të mbesin të habitura turmat e popujve.”

*Nga hagiografia e Dom Mark Gjanit*

Sapo e arrestuar, si një keqbërës të frikshëm, e çuan në burgun aty afërt, pranë kazermës së Sigurimit në fshatin Shpal. Nuk u gjykua dhe nuk u dënua. Më shumë se u arrestua, dom Mark Gjani u sekuestrua dhe u torturua në mënyrë të tmerrshme, madje iu mor shpirti. “Pasi e goditën me shkopinj për një javë rresht, ia dogjën këmbët me shufra hekuri të skuqur dhe me darë ia shkulën mishin në pjesë të ndryshme të trupit të mbushur me plagë...”. Kur e torturonin, në mënyrë shumë çnjerëzore dhe pa mëshirë me shufra hekuri dhe me çdo mjet tjetër, e detyronin të mohonte Krishtin. I vetëdijshëm dhe i përgjegjshëm për çdo veprim të tij, siç kishte qenë gjithmonë, përgjigjej duke bërë dëshmi të madhe: “Rroftë Krishti Mbret!”. Më shumë se i vdekur, i sflitur dhe duke dhënë shpirt, trupi i tij, i lidhur me një litar, u tërhoq nga burgu për më shumë se njëqind metra dhe u hodh në shpatinën aty afër ku “trupin ia hodhën qeneve”. Dhe nuk u mësua më asgjë. Gjon Mark Ndoj ka shkruar: “I humbi varri, por jo kujtimi!”.

*Nga Letra enciklike e Atit të Shenjtë Françesku “Vëllezër të gjithë”*

Shërbimi shikon gjithmonë fytyrën e vëllait, prek mishin e tij, ndjen afërsinë e tij dhe, në disa raste, derisa “vuan” edhe ai vetë për këtë gjë, dhe kërkon ngritjen e vëllait. Për këtë arsye, shërbimi nuk është kurrë ideologjik, meqë nuk u shërben ideve, por personave”.

**M. Të lutemi:**

O Zot Jezus, Fytyra e Atit, bëj që të dimë të të njohim në fytyrën e vëllezërve tanë, shpesh të shpërfytyruar nga vuajtja, dhimbja, zhgënjimi, frika dhe na ndihmo t’i thajmë me mëshirë dhe kujdes lotët e tyre. Ti që jeton e mbretëron në shekuj të shekujve.

**Mëshirë për ne, o Zot!**

*Mëkatet tona me i resitë,*

*e pa Krishtin krejt molitë,*

*Prej së rrahnash t’ asaj ditë.*

*Nanë e dashtun ...*



## TË NDALURIT E SHTATË

### JEZU KRISHTI BIE TË DYTËN HERË NËN KRYQ

**M. T'adhurojmë, o Krisht, e të bekojmë.**

**P. Pse me kryqin tënd të shenjtë e shpërbleve botën mbarë.**

***Prej librit të Isaisë Profet (Is 53, 4)***

“Ai i mori mbi vete vuajtjet tona, mbi shpatulla të veta i ngarkoi dhimbjet tona! E ne ishim të bindur se ishte i ndëshkuar, i munduar prej Hyjit e i nënçmuar!”

***Nga hagiografia e Dom Anton Zogajt***

Dom Anton Zogaj u arrestua nga policët e Sigurimit në ipeshkvi, natën vonë, në prani të arqipeshkvit Imzot Vençenc Prennushi me të cilin jetonte dhe që, edhe ai , u arrestua një ditë më vonë. Në momentin e arrestimit duke u ngritur tha: “Qe, jam gati” dhe u nis nga dera.

Si shenjë lidhjeje e dashurie, para se të ekzekutohej, arriti t’ia çonte Arqipeshkvit të vet, i cili vuante në qelinë pranë, pullat e talarit të vet, që nuk e kishte hequr as në burg, që i dha ngushëllim të madhe në mes të detit të mundimit të vet të pafund. Në momentin e ekzekutimit nuk deshi t’ia mbyllnin sytë, as nuk pranoi që të sillte shpinën. Kishte vetëdijen dhe perceptimin e gjallë të atij të cilit ia kishte kushtuar jetën dhe që në atë moment po e ndiqte më nga afër për t’u bërë përfundimisht i ngjashëm me të.

***Nga Letra enciklike e Atit të Shenjtë Françesku “Vëllezër të gjithë”***

Jemi krijuar për plotësinë që arrihet vetëm në dashuri. Të jetojmë shpërfillësh përpara dhimbjes nuk është një zgjedhje e mundshme; nuk mund të lëmë që dikush të mbetet “buzë jetës”. Kjo duhet të na indinjojë, deri në pikën që të na bëjë të zbresim nga qetësia jonë për të na tronditur me vuajtjet njerëzore. Ky është dinjitet.

**M. Të lutemi:**

O Zot Jezus, kujtohu për të krishterët, që në çdo kontinent të dëshmojnë në përndjekje dhe që martirizohen për besimin. Gjaku i tyre qoftë farë për të krishterët e rinj dhe shenjë e pranisë Sate të amshueshme. Ti që jeton e mbretëron në shekuj të shekujve.

**Mëshirë për ne, o Zot!**

*N'mal t' kalvarit kur e lëshoi,  
vetën kryq, e kur mbaroi,  
Krishtin pau e dhimshmja Zojë.*

*Nanë e dashtun ...*

**TË NDALURIT E TETË**  
**JEZU KRISHTI NGUSHËLLON GRATË**

**M. T'adhurojmë, o Krisht, e të bekojmë.**

**P. Pse me kryqin tënd të shenjtë e shpërbleve botën mbarë.**

*Prej librit të Isaisë Profet (Is 53, 11)*

“Shërbëtori im i drejtë do të shfajësojë shumë, mbi vete fajet e tyre do t’i marrë.”

*Nga hagiografia e Imzot Frano Gjinit, Ipeshkëv*

Një mysliman, që ishte së bashku me të në qelë, në atë periudhë, pohon se ishte guximtar, i qetë, i përvuajtë dhe sillej si të gjithë të tjerët. Imzot Frano Gjini nuk pranoi në asnjë mënyrë dhe nën tortura të tmerrshme që të bëhej një Kishë Katolike Kombëtare e ndarë nga Roma. Me këmbëngulje tha: “Unë nuk do ta ndaj kurrë grigjën time nga Selia e Shenjtë” dhe përseri “Nuk do ta bëj kurrë, derisa të kem jetë”. Kjo që arsyeja e vërtetë e pushkatimit.

Më 11 mars 1948 “u shoqërua natën së bashku me 18 viktimat e tjera, mes të cilëve edhe fretërit minorë Atë Çiprian Nikaj dhe Atë Mati Prendushi, përmes rrugëve të Shkodrës prej xhelatëve mes përplasjeve, përshtyrjeve dhe përuljeve të turpshëm dhe ndërsa ipeshkvi, duke kujtuar Kalvarin, e pranonte me qetësi gjithë këtë skenë cnjerëzore dhe mishngrënëse, në të njëjtën kohë përgatiste me fjalë atërore shokët e pafajshëm të fatkeqësisë për jetën e amshuar, duke i ftuar të thonin me gjithë zemër: “O Zot, fali se nuk dinë çfarë bëjnë”. Dhe i inkurajonte një për një duke u thënë: “Qëndro me guxim, se po vdes për Krishtin”.

*Nga Letra enciklike e Atit të Shenjtë Françesku “Vëllezër të gjithë”*

Kisha është një shtëpi me dyer të hapura, sepse ajo është nënë. Dhe si Maria, Nëna e Jezusit, duam të jemi një Kishë që shërben, që del nga shtëpia, që lë tempujt e vet, sakrestitë e veta, për të shoqëruar jetën, për të mbështetur shpresën, për të qenë shenjë njësie për të hedhur ura, për të prishur mure, për të mbjellë pajtim.

**M. Të lutemi:**

O Zot Jezus, të lutemi për të gjithë ne mëkatarët: na e jep hirin për t’u kthyer sa më shpejt. Ti që jeton e mbretëron në shekuj të shekujve.

**Mëshirë për ne, o Zot!**

*Deh ti nana më dashni,  
dhimbjen tande ban ta ndijë,  
Sa t’jetoj m’këtë shekull t’zi.*

*Nanë e dashtun ...*

## TË NDALURIT E NËNTË

### JEZU KRISHTI BIE TË TRETËN HERË NËN KRYQ

**M. T'adhurojmë, o Krisht, e të bekojmë.**

**P. Pse me kryqin tënd të shenjtë e shpërbleve botën mbarë.**

***Prej librit të Isaisë Profet (Is 53,8)***

“E hoqën këso jete me dhunë e me gjyq. Kush kujdeset për fatin e tij? Po, e zhbinë nga toka e të gjallëve, për faj të popullit të vet që goditur për vdekje.”

***Nga hagiografia e Atë Çiprijan Nikajt, O.F.M.***

Të gjitha mundimet dhe torturat i konsideronte dhuratë prej Zotit. Megjithëse i lidhur në zinxhirë, nuk e humbi stilin e tij dhe pasionin e tij meshtarak e misionar deri në fund. Madje, Atë Çiprian Nikaj, përdori zinxhirët, si Pali apostull, që të vazhdonte të bënte mirë. Në burg, një herë tha “Në këtë situatë kam një mision më shumë se të tjerët: duhet të ndez dritën kudo që ajo rrezikon të shuhet. Vuajtja sigurisht nuk është e këndshme, por fshikëron fitoren e arritur!”. Thonë disa, që kanë qenë në burg me të, se, kur kthehej prej torturave, të cilat e shoqëronin gjithmonë hetuesinë, e ndoshta ishte i sflitur, dhe kalonte para ndonjë të burgosuri si ai, thoshte me zë të lartë në latinisht, për të mos u kuptuar: “Si es catholicus, ego te absolvo a peccatis tuis in nomine Patris et Filii et Spiritus Sancti”, që do të thotë: nëse je një katolik, unë të zgjidh nga mëkatet e tua në emër të Atit dhe të Birit dhe të Shpirtit Shenjt.

***Nga Letra enciklike e Atit të Shenjtë Françesku “Vëllezër të gjithë”***

Falja nuk nënkupton harrimin. Kur ka diçka që në asnjë mënyrë nuk mund të mohohet, të relativizohet apo të fshihet, ne mund të falim gjithsesi. Kur ka diçka që nuk duhet të tolerohet, të justifikohet apo të shfajësohet, ne mund të falim gjithsesi. Kur ka diçka që për asnjë arsye nuk duhet t’ia lejojmë vetes që ta harrojmë, ne mund të falim gjithsesi.

**M. Të lutemi:**

O Zot Jezus, na bëj të kuptojmë që vetëm duke bashkëndarë dhimbjen e mundimeve të Tua mund ta shohim duke lindur në ne diellin e ngjalljes sate. Ti që jeton e mbretëron në shekuj të shekujve.

**Mëshirë për ne, o Zot!**

*Tuj tu lutë gjithmonë po shkoj,*

*ban që Krishtin ta adhroj,*

*Hirin tand kurrë mos ta lëshoj.*

*Nanë e dashtun ...*

## TË NDALURIT E DHJETË

### JEZU KRISHTIN E ZHVESHIN

**M. T'adhurojmë, o Krisht, e të bekojmë.**

**P. Pse me kryqin tënd të shenjtë e shpërbleve botën mbarë.**

*Prej librit të Isaisë Profet (Is 53,7)*

I marrë me të keq, lejoi të përvujtërohet dhe nuk e çeli gojën; ishte porsiq qengji që e çojnë për ta therur, porsiq delja e pazë para qethtarëve, nuk e çeli gojën e vet.

*Nga hagiografia e Atë Mati Prendushit, O.F.M.*

Madhështor në trup, ishte i mrekullueshëm në marrëdhënie me të tjerët. Përçonte besim, qetësi, siguri dhe guxim. Atë Matija, me gjithë fenë dhe formimin e tij kulturor të krishterë e donte atdheun në shpirtin e Skënderbeut, ëndërronte një atdhe të lirë, demokratik, të hapur ndaj botës. Nuk diti të qëndronte indiferent përpara shkeljeve të atyre që ishin në pushtet dhe me fjalën e qëndrimin e tij e shprehu kundërshtimin e tij. Në burg, nën tortura të pareshtura dhe kafshërore u soll si Krishti, duke vuajtur tmerrësisht dhe duke i falur të gjithë. Fjala e fundit ka qenë: “Jam i pafajëshmë, po vdes në krye të detyrës sime, Rroftë Krishti Mbret, rroftë Papa, rrofshin katolikët, rroftë Shqipnia, u bëj hallall Gjyqit dhe ato që do të shtijnë mbi trupat tona të pafajëshme”.

*Nga Letra enciklike e Atit të Shenjtë Françesku “Vëllezër të gjithë”*

Falja e lirë dhe e sinqertë është një madhështi që pasqyron pafundësinë e faljes hyjnore. Nëse falja është falas, atëherë mund të falen edhe ata që e kanë të vështirë të pendohen dhe nuk janë në gjendje të kërkojnë falje.

**M. Të lutemi:**

O Zot Jezus, bëj që të zhvishemi prej asaj që s'është e denjë, për t'u veshur me veshjen e bardhë, që Ti na e ke blerë me kryqin Tënd. Ti që jeton e mbretëron në shekuj të shekujve.

**Mëshirë për ne, o Zot!**

*Nanë e dashtun, t'lus pa pra,*

*varrët e t'brit tand pa da,*

*Gjurma n'zemër me m'i ba.*

## TË NDALURIT E NJËMBËDHJETË

### JEZU KRISHTIN E GOZHDOJNË NË KRYQ

**M. T'adhurojmë, o Krisht, e të bekojmë.**

**P. Pse me kryqin tënd të shenjtë e shpërbleve botën mbarë.**

***Prej librit të Isaisë Profet (Is 53,5)***

“Kurse Ai ishte i plagosur për shkak të paudhërive tona, i ndrydhur për shkak të fajeve tona; ndëshkimi, peng paqeje për ne, peshoi mbi të: me vërragën e tij ne u shëruam”.

***Nga hagiografia e Dom Dedë Planit***

Dom Dedë u arrestua pa një shkak të drejtë dhe as për një arsye çfarëdo, për të cilën mund të ndihej ose të thuhej se ishte përgjegjës. Me siguri për regjimin arsyeja ekzistonte dhe ishte eliminimi i meshtarëve, domethënë çrrënjësja e Kishës katolike prej Shqipërisë. Dom Deda ishte i pafajshëm dhe nuk kishte bërë gjë tjetër, veçse kishte predikuar atë që jetonte: dashurinë e Krishtit për çdo njeri dhe normat e Ungjillit. Nuk pësoj një gjyq të mirëfilltë, por në burg u trajtua barbarisht dhe këto tortura dëmtuan shëndetin e tij, që veç kishte qenë dhe ishte shumë i dobët. Njëra prej torturave më të zakonshme me të cilën torturoheshin viktimat ishte lënia, gjatë dimrit, në qelinë e ngushtë me dyshe-menë plot ujë. Dhe nën tortura, 57 vjeç, vdiq.

***Nga Letra enciklike e Atit të Shenjtë Françesku “Vëllezër të gjithë”***

Çdo dhunë e kryer ndaj një qenieje njerëzore është një plagë në mishin e njerëzimit; çdo vdekje e dhunshme na “zvogëlon” si njerëz. Dhuna lind dhunë, urrejtja lind më shumë urrejtje dhe vdekja sjell një tjetër vdekje. Duhet ta thyejmë këtë zinxhir që duket i pashmangshëm.

**M. Të lutemi:**

O Zot Jezus, Hyji ynë, i gozhduar në kryq për shpëtimin tonë, na jep neve dhe mbarë botës paqen që vjen prej Teje. Ti që jeton e mbretëron në shekuj të shekujve.

**Mëshirë për ne, o Zot!**

*Ti pjestar m'ban për gjithmonë,*

*n'atë mundim që për faj tonë,*

*Hoq mbi kryq shëlbuesi jonë.*

*Nanë e dashtun ...*

## TË NDALURIT E DYMBËDHJETË

### JEZU KRISHTI VDES NË KRYQ

**M. T'adhurojmë, o Krisht, e të bekojmë.**

**P. Pse me kryqin tënd të shenjtë e shpërbleve botën mbarë.**

***Prej librit të Isaisë Profet*** (Is 49,6)

“Unë po të caktoj të jesh drita e popujve që shëlbimi im të arrijë në skaj të tokës!”

***Nga hagiografia e Dom Ejëll Dedës***

I gjakosur dhe i shpërfytyruar në fytyrë dhe në trup aq sa nuk mund të njihej dom Ejëlli u lëshua plotësisht në duart e Zotin, duke e ditur se për të ai moment tragjik dhe i pakuptueshëm kishte një çmueshmeri të jashtëzakonshme për të mirën e vetë popullit të tij. “Gjithçka është në duart e Zotit. Zoti e di atë që është e mirë dhe atë që është e keqe për ne, sepse ne i shikojmë gjërat prej këtu poshtë, ndërsa Ai i sheh ndryshe prej qielli”. Pas një viti e katër muaj prej arrestimit, vdiq në infermerinë e burgut mes shokëve të vet të burgut dhe të vuajtjes. Një besimtar i famullisë, kur mori vesh për vdekjen e tij tragjike tha: “Na erdhi si engjëll dhe si i tillë iku”.

***Nga Letra enciklike e Atit të Shenjtë Françesku “Vëllezër të gjithë”***

E vërteta është një shoqëruese e pandashme e drejtësisë dhe e mëshirës. Të trija së bashku janë thelbësore për ndërtimin e paqes dhe, nga ana tjetër, secila prej tyre parandalon që dy të tjerat të ndryshohen. E vërteta nuk duhet të çojë në hakmarrje, por në pajtim dhe falje.

**M. Të lutemi:**

O Zot Jezus, i vdekur për të gjithë në kryq, ki mëshirë për ne krijesat e vdekshme. Në çastin e vdekjes, na dil përpara dhe na mirëprit. Na mbart në shpatulla, pasi t'i kesh larë mëkatet tona me Gjakun Tënd të paçmueshëm. Ti që jeton e mbretëron në shekuj të shekujve.

**Mëshirë për ne, o Zot!**

*Afër krygj's t'Birit Tenzot,  
ban, o Zojë me derdhun lot,  
Der' sa t'kemi jetë e mot.*

*Nanë e dashtun ...*

## TË NDALURIT E TREMBËDHJETË

### JEZU KRISHTIN E ULIN PREJ KRYQIT

**M. T'adhurojmë, o Krisht, e të bekojmë.**

**P. Pse me kryqin tënd të shenjtë e shpërbleve botën mbarë.**

*Prej librit të Isaisë Profet (Is 53, 11)*

“Për shkak të vuajtjes së shpirtit të tij do ta shohë dritën e do të ngihet me njohjen e saj. Shërbëtori im i drejtë do të shfajësojë shumë, mbi vete fajet e tyre do t'i marrë.”

*Nga hagiografia e Dom Lek Sirdanit*

Nuk kishin akuza për t'i bërë Dom Lekës dhe, prandaj, nuk i bënë as gjyq dhe as nuk e dënuan, por vetëm e keqtrajtuan mizorisht, dhe ai megjithëse i sflitur fizikisht, si Krishti, mbajti deri në fund një pamje të kthjellët dhe heshti. Në përvojën e vet njerëzore dhe të krishterë kishte pasur gjithmonë parasysh se “bota është plot me lot”, dhe një herë pati shtuar: “Kjo botë, meqenëse quhet plot me lot, ka nevojë edhe për lotët e mi”. Tortura më shtazarakë që ajo e hedhjes në gropën e hapur të ujërave të zeza ku, pasi e shtynë në fund me një sforc, vdiq i mbytur së bashku me dom Pjetër Çunin, ndërsa xhelatët i shanin dhe i provokonin duke u thënë: “Ku është Krishti juaj? Pse nuk ju ndihmon?”.

*Nga Letra enciklike e Atit të Shenjtë Françesku “Vëllezër të gjithë”*

Ai që e lë të rritet brenda vetes së vet, mirësia i jep atij një ndërgjegje të qetë, një gëzim të thellë edhe në mes të vështirësive dhe keqkuptimeve. Edhe përpara shkeljeve të pësuar, mirësia nuk është dobësi, por forcë e vërtetë, e aftë që të heqë dorë nga hakmarrja.

**M. Të lutemi:**

O Jezus, ne fshihemi pas plagëve të Tua. Na shpëto nga i keqi, që na sulmon. Na liro nga çdo e keqe. Na bëj ngadhënjyes mbi errësirën, që duket se fiton mbi dritën e ditëve tona. Ti që jeton e mbretëron në shekuj të shekujve.

**Mëshirë për ne, o Zot!**

*Afër kryqit tue gjimue,*

*Afër tejet tue lotue.*

*Kish të kjajë unë pa pushue.*

*Nanë e dashtun ...*

## TË NDALURIT E KATËRMBËDHJETË

### JEZU KRISHTIN E VARROSIN

**M. T'adhurojmë, o Krisht, e të bekojmë.**

**P. Pse me kryqin tënd të shenjtë e shpërbleve botën mbarë.**

**Prej librit të Isaisë Profet (Is 53, 9)**

“Varrin e tij e vunë me të patënzonët, me pasanikët varri i tij, megjithëse s’kishte bërë paudhësi, as gënjeshtër s’doli nga goja e tij”

**Nga hagiografia e Dom Pjetër Çunit**

Dom Pjetër Çuni ishte bariu i mirë i grigjës së vet dhe kudo që ushtroi mbarështimin e vet e vlerësuan dhe e deshën. Ishte një njeri dhe një meshtar i bindur se në lutje gjente bashkimin e tij intim me Hyjin dhe burimet për t’u përballuar me vështirësitë e panumerta që ndeshte gjatë mbarështimit.

Dom Pjetri, ashtu si edhe Krishti, u torturua mizorisht deri në vdekje; nuk iu kursyen shqelmat, grushtet dhe të rrahurat me çdo lloj mjeti. Mes të tjerash pësoi torturën me energji eletrike duke ia vënë dy fijet e korrentit në veshë, gjë vërtet e tmerrshme. Gjatë torturave u la të vdiste me turp, së bashku me dom Lek Sirdanin. Ende i gjallë, megjithëse pa ndjenja, sepse ishte i sflitur prej torturave, u hodh në gropën e zezë të kazermës. Dom Pjetri përsëriste shpesh: “Sikurse Krishti pësoi për fe, po vjen koha që do të pësojmë të gjithë ne, por duhet të qëndrojmë sikurse qëndroi ai”.

**Nga Letra enciklike e Atit të Shenjtë Françesku “Vëllezër të gjithë”**

Jemi të thirrur që t’i duam të gjithë, pa përjashtim, por të duam një shtypës nuk do të thotë ta lejojmë atë që të vazhdojë të jetë i tillë; dhe as që t’i lëmë të kuptojë se ajo që bën është e pranueshme. Përkundrazi, mënyra e mirë për ta dashur atë është të përpiqemi në mënyra të ndryshme për ta bërë atë të ndalojë shtypjen e tij, është t’i heqim atë pushtet që nuk di ta përdorë dhe që e deformon atë si qenie njerëzore.

**M. Të lutemi:**

O Jezus Shpëtuesi ynë, Ti që ke gjetur vdekjen për të na dhënë jetën e amshueshëm, jepu të vdekurve gëzimin dhe paqen e amshueshme. Ti që jeton e mbretëron në shekuj të shekujve.

**Mëshirë për ne, o Zot!**

*O Zojë virgjër, Nanë e dliirë,*

*lute Zotin të ketë mëshirë:*

*Ti shëlbim prej si na nxier.*

*Nanë e dashtun ...*



## **LUTIA PËRFUNDIMTARE**

### **Të lutemi**

Gjaku i martirëve të tu, o Zot, është bërë fara e Kishës sate.

Na bën të denjtë ta marrim trashëgimin e këtyre vëllezërve  
që na kanë parapri në fe e bën që dëshmia e tyre të jetë gjithmonë  
shembull e udhëheqje në gëzimet e në vështirësitë e jetës.

Na jep sigurinë që edhe në rrënojat e njeriut Ti, o Zot, gjithmonë rindërton e bën të rilindë.

Nëper Krishtin Zotin tonë. Amen.

### **Lutja për Kanonizimin e të Lumëve Imzot Vinçenc Prennushi me Shokë Martirë**

Trini e Shenjtë,  
Atë e Bir e Shpirt Shenjt,  
Ty të qofshin lavdi, ndera e bekimi,  
që ia ke dhuruar Kishës së shenjtë  
të Lumët Vinçenc Prennushi me 37 Shokë Martirë  
si model besnikërie ndaj Krishtit  
dhe dashurie të pakushtëzuar ndaj vëllezërve.  
Të lutemi me përvujtëri:  
ashtu si janë të Lumë tashmë në Qiell,  
denjohu tani t'i lavdërosh edhe këtu në tokë  
duke na dhënë hirin që aq shumë e dëshirojmë  
dhe që, me ndërmjetësinë e tyre të përbashkët,  
me besim të kërkojmë... (këtu bëhet kërkesa).  
Besojmë në Ty, o Zot. Ardhtë Mbretëria jote! Amen.

**Ati ynë. Të falemi Mari. Lavdi Atit ...**

**Shembulli i martirëve tanë na ndhimoftë të jemi dëshmitarë të fesë  
në historinë tonë të përditshme. Amen!**

***SHTOJCË***

### ***1- Imzot Vençenc Prennushi, Arqipeshkëv***

Lindi në Shkodër më 04.09.1885. Kushtet e Përjetshme i bëri në Salisburg (Austri) më 12.12.1904. U shugurua meshtar po në Salisburg më 19.03.1908. U zgjodh ipeshkëv i Sapës më 27.02.1936 dhe u shugurua në Shkodër më 19.03.1936. U transferua në selinë arqipeshkvnore të Durrësit më 26.06.1940. U arrestua më 19.05.1947 dhe u dënua me 20 vjet burg më 24.12.1947. Vdiq në burgun e Durrësit prej infarktut, shkaktuar prej keqtrajttimeve, torturave dhe kushteve të këqija ku jetoi, më 19.03.1949. Trupi i tij pushon në kishën e Shën Luçisë në Durrës. Martir i fesë.

### ***2- Atë Serafin Koda, O.F.M.***

Lindi në Kosovë më 25.04.1893. U shugurua meshtar më 30.06.1915. Mësues. Famullitar në Rajë-Mertur, Bizë, Shalë, Prekal, Bushkash, Vukël e Lezhë. Definitor e Ekonom Provincial. U arrestua dhe u burgos në Lezhë më 13.10.1946 në kuvendin e kthyer në burg. Pa gjyq dhe pa dënim, vdiq për shkak të torturave në Lezhë më 11.05.1947. Trupi i tij pushon në kishën e Fretërve Minorë të Lezhës.

### ***3- Vëlla Gjon Pantalia, S.I.***

Lindi në Prizren (Kosovë) më 02.06.1887. Studioi në vendlindje. Formimin e vet kulturor e plotësoi në mënyrë autodidakte. Qe Vëlla koadiutor, pjesë e Misionit Shëtitës dhe mësues në shkollën fillore, ekonom, drejtor i shtypshkronjës, administrator i revistave “Lajmëtari” e “LEKA” dhe drejtues artistik: drejtor i korit, i bandës dhe regjizor teatri. U arrestua në vitin 1946 në kuvendin e Shën Françeskut në Gjuhadol ku po banonte pas mbylljes së çdo veprimtarie të Seminarit Papnor Shqiptar. Vdiq gjatë torturave në Shkodër më 31.10.1947.

### ***4- Dom Anton Muzaj***

Lindi në Kosovë më 12.05.1921. U shugurua meshtar i dioqezës së Shkodrës më 19.03.1944. Prej vitit 1930 ka ndjekur shkollën pranë Kolegjit Saverian të Jezuitëve të Shkodrës. Prej vitit 1938 në Romë, ka ndjekur bakalaureatin në Filozofi dhe Liçencën në Teologji në vitin 1944. U arrestua në Shkodër dhe u burgos në Kuvendin e Gjuhadolit më 20.05.1947. U dënua me një vit burg. Pasi u sëmur rëndë për shkak të torturave, u dërgua të vdiste në katin përdhësë të arqipeshkvisë në pranverë të vitit 1948. Trupi i tij u zhvarros prej varrezave katolike të Shkodrës me rastin e Lumnimit.

### ***5- Atë Bernardin Palaj, O.F.M.***

Lindi në Shkodër më 02.10.1894. Ndoqi të gjitha shkollat e Fretërve Minorë të Shkodrës, kurse liceun e bëri në Salisburg dhe Filozofinë e Teologjinë në Insbruk (Austri). U shugurua meshtar më 02.08.1918. Dha mësim gjuhë shqipe dhe latine në Gjymnazin Illyricum të Fretërve Minorë. Punoi në famullitë e Toplanës, Palçit, Shalës, Bushkashit, Planit dhe Rubikut. U arrestua në Rubik, në kuvendin ku ishte Epror, dhe u burgos në Shkodër më 22.10.1946. Vdiq në burgun e Shkodrës, prej torturave, përpara se të dënohej, më 02.12.1946.

### ***6- Dom Mark Gjani***

Lindi në Shën Gjergj (Mal i Zi), që në atë kohë i përkiste dioqezës së Shkodrës, më 10.07.1909. I dioqezës së Abacisë së Shën Llezhdrit të Oroshit, tani të Rrëshenit. U shugurua meshtar në Itali më 21.03.1942. Famullitar i Oroshit dhe i Kalivarit (Mirditë). Sekretar i Imzot Frano Gjinit. U arrestua në Kalivar dhe u burgos në Shpal në vitin 1945. Pa gjyq dhe pa dënim, vdiq gjatë torturave në Shpal në vitin 1947.

### ***7- Dom Anton Zogaj***

Lindi në Kthellë (Mirditë) më 26.07.1908. I dioqezës së Durrësit. U shugurua meshtar më 26.04.1932. Pas shugurimit u emërua famullitar i Shna Prendes në Kurbin, pastaj i katedrales së Shën Luçisë në Durrës, pastaj Kancelar i arqipeshkvit dhe Sekretar i Imzot Vinçenc Prennushit. U arrestua në Durrës më 18.05.1947, një ditë përpara Imzot Vinçenc Prennushit (19.05.1947) dhe po aty u burgos. U gjykua në Durrës më 29.08.1947 dhe u dënua me vdekje më 24.12.1947. Pa bërë një vit të plotë burg, u pushkatua pranë Porto Romanos në Durrës, më 09.03.1948.

### **8- Imzot Frano Gjini, Ipeshkëv**

I lindur në Shkodër, më 20.02.1886. U shugurua meshtar më 28.06.1908. Në vitin 1918 u emërua Vikar i Përgjithshëm i Arqidioqezës së Durrësit. Tre herë qe famullitar i Durrësit, pastaj në Derven të Fushë Krujës, Kurbin dhe Perlat të Kthellës. U shugurua Ipeshkëv më 28.10.1930 për Abacinë Nullius të Shën Llezhdrit të Oroshit në Mirditë. Më 11.11.1945 iu besua përkohësisht regjencia e Delegacionit Apostolik të Shqipërisë me të gjitha kompetencat e Delegatit Apostolik, duke zëvendësuar Imzot Nigris-in që, pasi ishte nisur për Romë në fund të marsit të vitit 1945, regjimi nuk e lejoi të hynte më në Shqipëri. Më 04.01.1946 u transferua në selinë e Lezhës, me banim në Kallmet, duke vazhduar të jetë Administrator Apostolik i Abacisë Nullius të Oroshit. U arrestua në Shkodër më 15.11.1946, u dënua me vdekje më 08.01.1948 dhe u pushkatua më 11.03.1948.

### **9- Atë Çiprijan Nikaj O.F.M.**

Lindi në Shkodër më 19.07.1900. Studioi në Seminarin e Fretërve Minorë të Shkodrës, pastaj në Lankowitz dhe Grac (Austri) dhe Teologjinë në Romë dhe Peshia (Itali). U shugurua meshtar në Romë më 25.07.1924. Dha mësim në Seminarin e Fretërve Minorë. Mësues i xhakojve (1929-1932), Mësues i novicëve (1932-1938), Ministër Provincial (1938-1941), Drejtor i Seminarit Françeskan (1941-1944), Guardian i Gjuhadolit prej vitit 1944 derisa vdiq. U arrestua në Shkodër dhe u burgos më 15.11.1946. U dënua me vdekje më 28.12.1947 dhe u pushkatua më 11.03.1948.

### **10 - Atë Mati Prendushi, O.F.M.**

Lindi në Shkodër më 02.10.1881. Filozofi studioi në Schwaz dhe Teologji në Kaldaro (Itali) e Grac (Austri). U shugurua meshtar në Shkodër më 25.03.1904. Ishte famullitar në Tuz, Kastrat e Trabohin, Guardian i Gjuhadolit, Definitor Provincial, famullitar në Laç, Iballë, Gomsiqe e Bërdicë dhe pastaj Vikar Provincial. Prej vitit 1941 deri në vitin 1943 veproi në Tiranë. Prej vitit 1943 Delegat Provincial, duke zëvendësuar Ministrin Provincial Atë Anton Harapin, meqë kishte hequr dorë pasi e kishin thirrur që të qenë pjesë e Regjencës. Prej vitit 1944 Ministër Provincial derisa e pushkatuan. U arrestua dhe u burgos në Shkodër më 15.11.1946; u dënua me vdekje më 08.01.1948 dhe u pushktua më 11.03.1948 së bashku me të sivëllain Atë Çiprijan Nikajn, ipeshkvin Imzot Frano Gjinin e të tjerë.

### **11- Dom Dedë Plani**

Lindi në Shkodër më 21.01.1891. Studioi Filozofi në Seminarin Papnor të Shkodrës dhe Teologji në Insbruk (Austri) në Kolegjin Canisianum të Jezuitëve. U shugurua meshtar në Primiz (Austri) më 03.08.1919. Prej marsit të vitit 1920 qe famullitar i Gimajve të Shalës, pastaj i Pogut, i Prekalit, i Kirit, i Shirokës dhe, prej vitit 1947, i Rrencit të Gurit të Zi. U arrestua dy herë, në vitin 1945 në Shirokë dhe u lirua disa muaj më pas. U arrestua përfundimisht në Rrenc të Gurit të Zi në shtator-tetor të vitit 1947 dhe u burgos në Shkodër. Vdiq gjatë torturave, përpara se të dilte në gjyq, më 30.04.1948.

### **12- Dom Ejëll Deda**

Lindi në Shkodër më 22.02.1917. Shkollën fillore e bëri në shkollën e Lagjes Ballabane të Shkodrës. Pastaj vazhdoi, më përpara, te fretërit dhe, pastaj, te Seminari Papnor Shqiptar në Shkodër dhe, në fund, te Propaganda Fide në Romë. U shugurua meshtar në Shkodër më 24.02.1943. Ka qenë famullitar në Rranxa të Bushatit. U arrestua në Rranxa të Bushatit më

10.01.1947 dhe u burgos në Shkodër. U dënua me 10 vjet burg dhe punë të detyruar. Vdiq në infirmierinë e burgut më 12.05.1948.

### ***13- Dom Lekë Sirdani***

Lindi në Gurëz më 01.03.1891. U shugurua meshtar në Shkodër më 24.04 1916. Famullitar i Bogës, Shkrelit, Reçit e Mazrreikut. U arrestua në Bogë dhe u burgos në Koplík më 27.07.1948. Vdiq gjatë torturave, pa gjyq, i mbytur në gjiriz në Koplík më 31.07.1948, edhe pse lajmi i vdekjes së tij, ndodhur bashkë me Dom Pjetër Çunin, iu dha të atit më 26.12.1948.

### ***14- Dom Pjetër Çuni***

Lindi në Shkodër më 09.07.1914. Filozofinë e bëri në Seminarin Papnor Shqiptar të Shkodrës, kurse Teologjinë në Kolegjin e Kongregatës Propaganda Fide të Romës. U shugurua meshtar në Romë më 23.03.1940. Në fillim qe famullitar në Shkrel dhe pastaj në Rrjoll, prej nga ku shërbente edhe në Lohe e Reç. U arrestua në Rrjoll dhe u burgos në Koplík më 27.07.1948. Vdiq gjatë torturave, pa gjyq, i mbytur në gjiriz në Koplík më 31.07.1948, edhe pse lajmi i vdekjes së tij, ndodhur bashkë me Dom Lek Sirdanin, iu dha të atit më 26.12.1948.

Nën kujdesin

e Motrave Klarise

Manastiri “Sh. Kjara”

Rruga M. Barleti

Bulevardi Skanderbeg

Shkodër